

URDHËR
Nr.327, datë 18.5.2020

PËR DISA SHTESA DHE NRYSHIME NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020
“PËR MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016,“Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193 datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si vijon:

1. Në të gjithë përmbajtjen e urdhërit fasha orare zgjatet deri në orën 21:00.
 2. Paragrafi i parë e pikes 1/1 shfuqizohet.
 3. Në të gjithë vendin, hiqen autorizimet për lëvizjen e këmbësorëve apo automjeteve gjatë javës.
 4. Çdo parashikim në udhrat e mëparshëm që bie në kundërshtim me këtë urdhër, shfuqizohet.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu